


MIRËQENIA



SHOQËRORE

KUVENDI, SHTËPIA E DEPUTETËVE

ARJETA (12), VJONA (11), ELMEDINA (11), ENIS (11), KUSHTRIM (11), SERXHANE (16), NAZMIJE (12)



Ne jemi shumë të lumtur që jemi pjesë e Punëtorisë së Demokracisë dhe që kemi mësuar për Kuvendin. A dëshironi të mësoni edhe ju për Kuvendin? Atëherë, lexojeni artikullin tonë

Sot kemi mësuar për institucionin më të rëndësishëm për ne, qytetarët. Ky institucion quhet Kuvendi i Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë. 100 nga ta janë shqiptarë, që do të thotë se i përkasin komunitetit shumicë të Kosovës. Ndërsa, 20 të tjerë iu përkasin komuniteteve jo shumicë, të cilët po ashtu jetojnë në Kosovë. 10 nga ta janë qytetarë serbë, kurse 10 të tjerë janë qytetarë ashkali, romë, turq, boshnjak, egjiptianë dhe goranë. Kurse edhe ju mund të pyesni veten se kush i ka zgjedhur këta deputetë? Deputetët e Kuvendit të Kosovës janë të zgjedhur nga votat e qytetarëve. E kush ka të drejtë të votojë? Ne e dijmë se e drejta e votës na takon të gjithëve, pa dallim. Kushti i vetëm

është se duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare. Deputetët kanë për detyrë, përveç tjerash, të miratojnë ligjet për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ligjet janë rregulla, të cilat vlejnë për të gjithë qytetarët njësoj. Edhe ne si nxënës iu bindemi ligjeve, pasi që ato rregullojnë jetën tonë.

Pa ligjet nuk imagjinohet jeta jonë. Për të ilustruar ne-



Për këtë artikull, ne kemi punuar shumë

vojën e ligjeve, ne kemi paraqitur disa nga rregullat e shkollës sonë. Këto rregulla janë të vendosura në secilën klasë dhe në koridore të shkollës në mënyrë që të shihen nga të gjithë nxënësit. Në këto rregulla hyjnë: të mos bëjmë zhurmë në klasë gjatë orës së mësimit të mos hamë në orë të mësimit, ta dëgjojmë mësuesen çfarë thotë, të mos vrapojmë në korridor, të mos largohemi nga orët e mësimit, etj. Rregullat janë bërë për ne dhe ne duhet t'i respektojmë ato.




Gazetarët e mirë e të sjellshëm ashtu si edhe na ka hije në demokraci




Çdo gjë që ne e bëjmë, e bëjmë që të jemi të lumtur

Përvoja jonë si gazetarë, na bëri që të reflektojmë shumë për veten dhe për atë çka ne dëshirojmë të bëjmë në të ardhmen tonë. Kosova është shtet demokratik, dhe për këtë arsye, ne gëzojmë shumë të drejta. Demokracia ka disa vlera të cilat ne si individë duhet t'i posedojmë. Vlerat e demokracisë janë: re-

spekti reciprok, toleranca, solidariteti, gjithëpërfshirja, liria, paqja, etj. Këto vlera neve na ndihmojnë që të kemi një personalitet të mirë dhe të jemi qytetarë demokratikë. Përmes këtyre vizatimeve ne kemi paraqitur demokracinë ashtu siç e shohim. Shpresojmë që t'iu pëlqejnë vizatimet tona.



E mira e demokracisë është se të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeçare, e kanë të drejtën e votës



Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore dhe ato lokale




Në demokraci fuqia i takon popullit, por fuqinë tonë ne ia kalojmë deputetëve, në mënyrë që ata të na përfaqësojnë



Në një shtet demokratik, të gjithë qytetarët i kanë të drejtat e barabarta, pa asnjë dallim

MEDIA, BURIM I INFORMATAVE

RAMIZË (12), VIONA (11), RIAD (11), ALTINA (11), GRANIT (11), LULJETA (11), ANITA (11)



Media si pushtet i katërt, ka rëndësi të madhe për ne. Përmes saj, ne informohemi për çdo gjë

Ne si fëmijë, jemi shumë të interesuar të dijmë dhe të mësojmë shumë gjëra të reja. Për shembull, një shoqe jona e cila quhet Viona, ka një interes të theksuar për lëndën e biologjisë. Ajo ka dëshirë të mësojë më shumë për qeniet e gjalla, të cilat ndodhen në natyrë. Këto informata, ajo i merr përmes një kanali televiziv që shfaq dokumentare. Pastaj, një shoqe tjetër e cila quhet Altina, e pëlqen shumë lëndën e gjeografisë. Ajo ka dëshirë të mësojë më shumë për planetet, e shumë gjëra të tjera rreth kësaj lënde. Ajo i merr këto informata prej një emisioni në radio. Ndërsa, një shok i yni, i cili quhet Riad, e pëlqen shumë gjuhën angleze. Për ta përvetësuar këtë gjuhë, ai përdor kompjuterin dhe internetin. Të gjitha këto burime për marrjen e informacioneve, hyjnë tek media.

Ne, çdo ditë jemi në kontakt të vazhdueshëm me median. Mirëpo, sot e kuptuam sesa e rëndësishme është ajo dhe sesa na ndihmon neve si nxënës.

Media ndahet në dy grupe: media e shkruar dhe media elektronike. Në median e shkruar bëjnë pjesë: librat, gazetat, revistat, lekturat, etj. Ndërsa, në media elektronike bëjnë pjesë: radio, televizioni, kompjuteri, telefoni, etj.

Jemi shumë të lumtur që jetojmë në një epokë, ku teknologjia është në majet e saja të zhvillimit. Kjo na jep neve shumë hapësirë që të hulumtojmë për atë se

çka na intereson.

Çka kërkohet prej nesh është të dijmë se si ta shfrytëzojmë teknologjinë, e ta përdorim atë vetëm për gjëra pozitive, e që neve na hyjnë në punë.



Gazetarë të medias së shkruar



Punimi i Riadit, i cili lidh mendimet e njerëzve me median

AKTIVIZIMI YNË NDIKON ZHVILLIMIN E VENDIT

ERIJON (11), BLEDI (11), BLEONA (11), LEONORA (13), MAKFIRETE (11), AMIR (11)



Zhvillimi i vendit është mjaft i rëndësishëm për ne nxënësit. Prandaj, mendohe mi të jemi aktiv në forma të ndryshme. Për të mësuar se si e bëjmë këtë, vazhdoni ta lexoni artikullin tonë

Unë jam Leonora, qytetare aktive në shtetin tim. E quaj veten qytetare aktive edhe pse për nga mosha jam vetëm 13 vjeçare, që nënkupton se ende jam fëmijë. Si fëmijë që jam, unë dhe të gjithë moshatarët e mi, jemi shumë kurioz për çështje të ndryshme. Prandaj, parashtrijmë vazhdimisht pyetje dhe jemi të preokupuar për të ardhmen e shtetit tonë. Për t'i dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve dhe dilemave që i kemi, kemi zgjedhur të aktivizohemi. Kjo i bie se ne kemi zgjedhur të jemi qytetarë aktiv dhe jo pasiv.

Këtë po e bëjmë duke dhënë ide të ndryshme dhe duke i vënë në funksion ato. Një iniciativë të fundit që e kemi marrë ka të bëjë me vizitën tonë në organizatën joqeveritare TOKA, ku tashmë jemi bërë pjesë e projek-

tit për demokracinë „Demos-ti“. Por si lidhet kjo vizitë me qytetarinë aktive? Normalisht se ka lidhshmëri, sepse ne këtu mësojmë për vlerat demokratike.

Pastaj, informatat e marra i ndajmë me të tjerët. Kjo nënkupton se edhe shpërndarja e informatave bën pjesë në qytetarinë aktive. Pjesë e qytetarisë aktive janë edhe punët e ndryshme vullnetare, ndihmat që ofrohen ndaj familjeve të ndryshme, zbatimi i elementeve të demokracisë, etj. Qytetarë të dashur, ne jemi baza e ndërtimit të një shteti të zhvilluar dhe demokratik. Nga ne kërkohet të jemi mendjehapur dhe të përgjegjshëm për veprimet që i bëjmë, sepse veprimet tona shpeshherë nuk na ndikojnë vetëm ne, por edhe të gjithë qytetarëve të tjerë. Shembull të tillë të ndikimit i kemi zgjedhjet shtetërore, ku vota e secilit qytetar e ndikon jetën dhe të ardhmen e popullit.

Prandaj, iu ftojme të jeni aktiv, sepse shteti demokratik nuk ndërtohet pa ndihmën tonë.



Informimi, rruga drejt dijes



Qytetarët e interesuar për vlera e demokracisë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Fehmi Agani“
Klasa: VI
Vendi: Medvec, Lipjan